

Ju ndoshta jeni përballur me afazinë për herë të parë vetëm së fundi. Në fillim, afazia nxit pyetje si: çfarë është afazia, si zhvillohet, dhe se çfarë problemesh të tjera mund të shfaqen?

Çfarë është afazia?

Çdo qenie njerëzore përdor gjuhën. Të folurit, gjetja e flakëve të duhura, të kuptuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe kryerja e gjesteve janë pjesë e përdorimit të gjuhës nga ana jonë. Nëse si rezultat i dëmtimit të trurit, një ose disa pjesë të përdorimit të gjuhës ndalon së funksionuari siç duhet, kjo quhet afazi. Afazia - A (=mos) phasia (=e folura) do të thotë se dikush nuk mund të thotë më atë që ai ose ajo dëshiron. Ai ose ajo nuk mund të përdorë më gjuhën. Përveç afazisë, mund të shfaqen paraliza dhe/ose probleme lidhur me:

- veprime të ndërgjegjshme,
 - vështrim të ambientit përreth,
 - përqendrimin, marrjen e iniciativave, dhe kujtesën.
- Njerëzit nuk mund të bëjnë më dy gjëra në të njëjtën kohë.

Shumë njerëz e përjetojnë zhgënjimin gjatë pushimeve të tyre jashtë vendit, ku nuk janë të aftë të shprehin qartë se çfarë duan të thonë, ose ku nuk kuptojnë saktë se çfarë thonë njerëzit e tjerë. Edhe në vendet ku ne e zotërojmë mirë gjuhën, ne mund ta provojmë këtë për shembull kur vizitohemi te një doktor. Në vendet ku ne nuk e zotërojmë gjuhën aq mirë, kapacitetet tona të komunikimit me popullsinë vendase bëhen edhe më të kufizuara, dhe as nuk do t'ia arrijmë gjithmonë të porositim ushqimin që vërtet duam të hamë. Njerëzit që vuajnë nga afazia i përjetojnë këto probleme çdo ditë. Afazia është pra një çrregullim gjuhësor. Nuk ka dy persona që vuajnë nga afazia që të jenë njëllor: afazia është e ndryshme te të gjithë. Gjendja e rëndë dhe shtrirja e afazisë varet, ndër të tjera, në pozicionin dhe nivelin e dëmtimit të trurit, aftësinë e mëparshme linguistike dhe personalitetin e personit. Disa njerëz me afazi mund ta kuptojnë mirë gjuhën, por kanë vështirësi në gjetjen e fjalëve të duhura ose ndërtimin e fjalive. Të tjerë, nga ana tjetër, flasin shumë, por ajo që thonë nuk është e kuptueshme ose është e vështirë për tu kuptuar nga bashkëbiseduesi i tyre; këta njerëz zakonisht e kanë shumë të vështirë për të kuptuar gjuhën. Aftësia linguistike e shumicës së njerëzve me afazi është diku midis këtyre ekstremeve. Kini parasysh: dikush që vuan nga afazia në përgjithësi zotëron kapacitetet e tij të plota intelektuale!

Pothuajse gjithmonë ka disa rigjenerime spontane të gjuhës gjatë ecures së afazisë. Ky rigjenerim është rrallëherë ose asnjëherë i plotë. Megjithatë, me shumë ushtrime, përpjekje dhe këmbëngulje, mund të arrihen disa përmirësime.



Ecuria e afazisë

Afazia zhvillohet si rezultat i dëmtimit të trurit. Origjina i një dëmtimi të tillë në tru është kryesisht një çrregullim i enëve të gjakut. Një çrregullim i tillë quhet gjithashtu një goditje, hemorragji cerebrale, infarkt cerebral ose apopleksi. Në terminologjinë mjekësore ajo quhet CVA: Cerebral (=truri) Vascular (=enë gjaku) Accident (=aksidenti). Shkaqe të tjera për zhvillimin e afazisë janë për shembull, një traumë (një dëmtim i trurit si rezultat, për shembull, i një aksidenti (rrugor) ose një tumori në tru. Truri ynë ka nevojë për oksigjen dhe glukozë në mënyrë që të punojë. Nëse si rezultat i një CVA ose për një nga shkaqet e tjera, qarkullimi i gjakut në tru ndërpritet, qelizat e trurit në atë vend vdesin. Në tru ndodhen të gjithë llojet e zonave me funksione të ndryshme. Për shumicën e njerëzve, zonat për përdorimin e gjuhës ndodhen në gjysmën e majtë të trurit. Në rast të dëmtimit në këto zona gjuhësore, flasim për afazi.

Çfarë problemesh të tjera mund të shfaqen?

Rrallë ndodh që dikush të vuajë vetëm nga afazia. Shpesh zona të tjera të trurit janë gjithashtu të prekura. Shembuj të problemeve të tjera janë:

- gjendje hemiplegjike (hemi=gjysëm, plegic=paralizë). Për njerëzit që vuajnë nga afazia, kjo është zakonisht pjesa e djathtë e trupit. Preket kontrolli i muskujve në një anë të trupit, dhe si rezultat muskujt nuk bashkëpunojnë më aq mirë.
- humbje të gjysmës së shikimit (hemianopsia, hemi=gjysëm, opsia=të shohësh). Përgjithësisht, njerëzit mund të shohin gjithçka që ndodhet në anën e gjysmës së shëndoshë të trupit, por jo gjërat që ndodhen në anën e tyre të prekur.
- mosnjohje e mëpasshme se si duhet të kryhen veprime të caktuara (apraksia, a=mos, praxia=përkryerje). Veprime të thjeshta si të veshurit, të ngrënit dhe të pirit papritur mund të mos kryhen më në mënyrë të ndërgjegjshme. Dikush që vuan nga apraksia, për shembull, nuk e di se si të fikë një qiri nëse i kërkohet kjo gjë (veprim i ndërgjegjshëm), ndërsa ai e fik automatikisht një shkrepëse që ai ose ajo e ka në dorë nëse ka rrezik të djegë gishtat.
- probleme me të ngrënit, të pirit dhe gëlltitjen (disfagia, dys=jo mirë, phagia=gëlltitje). Për shkak të dëmtimit të trurit, muskujt digastrikë dhe të gëlltitjes mund të paralizohen, të bëhen shumë të ndjeshëm ose edhe të pandjeshëm. Kjo e bën të ngrënit dhe të pirit një detyrë të vështirë. Për shkak të paralizës dhe humbjes së ndjeshmërisë në një pjesë të faqes, pështyma mund të rrjedhë nga një cep i gojës pa u vënë re.
- probleme kujtese. Kur kujtoni informacione, gjuha luan një rol të madh. Për shkak të problemeve gjuhësore, kujtesa duket se nuk funksionon aq mirë. Për këtë arsye, shënoni gjithmonë disa fjalë kryesore; kjo e bën më të lehtë të kujtohen gjërat për dikë që vuan nga afazia.
- reagim i ndryshëm. Ndonjëherë njerëzit reagojnë plotësisht ndryshe ndaj ngjarjeve pas goditjes nga hemorragjia cerebrale në krahasim me më parë. Kontrolli ndaj shprehjes së emocioneve është bërë më i vështirë. Mund të ndodhë që dikush të qeshë dhe të qajë më shpesh. Mund të ndodhë gjithashtu që ai ose ajo ta ketë më të vështirë të ndalojë së bëri këtë.
- epilepsi. Kur truri rigjenerohet nga një dëmtim, një ind krijohet në tru. Ndonjëherë, ky ind i mbetur nga dëmtimi shkakton një qark të shkurtër, le të themi, brenda trurit. Si rezultat i kësaj, trupi dridhet, personi shpesh ka probleme me frymëmarrjen, dhe ai ose ajo mund të humbë ndjenjat. Një krizë e tillë epilepsie zgjat vetëm disa minuta, por ajo shpesh ndodh papritur dhe frika për personin që vuan nga ajo, si dhe për familjen, është si rrjedhojë e madhe.

Lista e mësipërme me probleme shtesë nuk është në asnjë mënyrë e plotë. Simptomat e afazisë dhe pasojat e tjera janë të ndryshme për çdo qenie njerëzore. Çdo problem i sipërpërmendur mund të ndodhë në ndërthurje me afazinë, por nuk është e thënë patjetër.

Trajtimi i afazisë

Shumë persona që vuajnë nga afazia janë shtruar në spital për një kohë të caktuar. Ky shtrim në spital shpesh ka ndodhur pas dëmtimit në tru. Pas largimit nga spitali, shumë persona me afazi kanë nevojë ende për trajtim të mëtejshëm. Nuk është gjithmonë e qartë se te kush mund të drejtohen ata për ndihmë. Ju lutemi këshillohuni me doktorin që ju kuron mbi mundësitë në zonën tuaj. Trajtimi i afazisë pothuajse gjithmonë sigurohet nga terapeutët e të folurit. Në parim, kushdo që vuan nga afazia ka të drejtë për terapi të të folurit. Kohëzgjatja e trajtimit është, ndër të tjera, e lidhur me rigjenerimin nga afazia, dhe me mundësitë dhe rregullat në vendin ku jetoni.

Udhëzime për komunikimin

Për shkak të afazisë, mënyra se si dikush kupton diçka ose shprehet shpesh ndryshon. Duke përdorur sa më mirë mundësitë e mbetura të komunikimit, njerëzit mund të komunikojnë akoma me dikë që vuan nga afazia. Dikush me afazi të përparuar shpesh kupton vetëm fjalët kryesore në një fjali. Ai ose ajo kupton 'fjalët kyçe'. Të kuptosh gjërat përmes fjalëve kyçe mund të shkaktojë keqkuptime, pasi për shkak të ndërthurjes së fjalëve kyçe dhe njohurive të përgjithshme mbi gjërat, mesazhi mund të keqkuptohet. Ndonjëherë, ne dhe dikush që vuan nga afazia mendojmë se e kemi kuptuar saktë njeri-tjetrin. Një reagim i mëvonshëm ndonjëherë tregon se nuk ka ndodhur kështu.

Nëse do të dëshironit t'i thoshit diçka dikujt me afazi

- Para së gjithash, merreni bisedën ngadalë. Uluni rehat dhe mbani kontakt pamor me sy.
- Nëse druheni të bisedoni, tregoni diçka të thjeshtë mbi veten tuaj dhe më pas bëni pyetje për të cilat e dini aktualisht përgjigjen.
- Flisni ngadalë dhe me fjali të shkurtra, dhe theksoni fjalët më të rëndësishme në një fjali.
- Shkruani fjalët më të rëndësishme. Përsëriteni mesazhin dhe jepini pacientit me afazi atë që keni shkruar. Pacienti me afazi mund ta përdorë atë për kujtesë ose si një mjet komunikimi.
- Ndhimoheni dikë që vuan nga afazia për problemet e tij ose saj kur ata shprehen, duke treguar, bërë gjeste, duke vizatuar ose shkruar, dhe pyesni nëse ai ose ajo mund të tregojë, të bëjë gjeste, të vizatojë ose të shkruajë diçka nga kjo. Kërkoni së bashku në fjalorin e xhepit ose librin e bisedimeve.


Nëse dikush me afazi dëshiron t'ju tregojë diçka

Së pari, duhet të jetë e qartë se për kë flitet, çfarë ndodh ose ka ndodhur, dhe mundësisht ku ose kur ndodh ose ka ndodhur ngjarja. Është shumë e rëndësishme që të bëni pyetjet e duhura, të jeni krijues dhe të vazhdoni aq sa mundet në mënyrë sistematike. Gjithmonë përpiquni të bëni pyetje me shumë mundësi përgjigjeje, ku të paraqisni çështjet që mund të përzgjidhen pranë njëra-tjetrës.

Ndihma komunikimi

Në shumë vende ka libra të veçantë me figura treguese me fjalë dhe vizatime. Duke treguar fjalët ose vizatimet, dikush mund të bëjë të qartë atë që kërkon të thotë. Këshillohuni me doktorin ose terapeutin tuaj nëse ndihmesa të tilla janë gjithashtu të disponueshme në vendin tuaj. Në rast se nuk është kështu, mund ta bëni vetë një libër për komunikimin. Në të mund të përfshini figura ose pamje dhe fjalë që janë të rëndësishme për personin që vuan nga afazia. Në këtë mënyrë mund të zhvillohet një diskutim mbi ngjarjet dhe të diskutohen ndjenjat.





Kur komunikoni me dikë që vuan nga afazia me anë të një libri të tillë me figura treguese, mund të përpiqeni e të kërkonti së bashku për koncepte që janë të rëndësishme për diskutimin. Kini parasysh që të keni laps e letër në dorë. Atëherë mund të shkruani fjalët më të rëndësishme nga biseda poshtë njëra-tjetrës, në mënyrë që të bëhet më e lehtë ndjekja dhe mbajtja mend e përmbajtjes së bisedës.

Durimi i mposht të gjitha

Kryerja e një diskutimi me dikë që vuan nga afazia kërkon mjaft kohë dhe durim. Përveç këshillave të sipërpërmendura mund të ndodhë që mos ta kuptoni ende njeri-tjetrin. Lëreni të pushojë për pak, dhe provojeni përsëri më vonë; ndoshta do të jeni më i suksesshëm!

Më shumë informacion

Në faqen e internetit të Association Internationale Aphasie (AIA) mund të gjeni më shumë informacione mbi afazinë në gjuhë të ndryshme:

www.aphasia-international.com. Këtu do të gjeni gjithashtu lidhje me shoqatat kombëtare të afazisë dhe secila ofron informacione mbi afazinë në gjuhën e tyre.

Qëllimi i kësaj faqe interneti është të sjellë afazinë në qendër të vëmendjes, dhe të nxisë themelimin e grupeve të kontaktit për bashkëvuajtësit, në mënyrë që të parandalojë që njerëzit që vuajnë nga afazia të përfundojnë në izolim social.